

# Shpjegime detajuese për vlerësimin përshkrues

---

## Vlerësimi përshkrues:

Vlerësimi përshkrues, shërben për të vlerësuar me korrektësi çdo përparim të nxënësit dhe çdo nevojë për përmirësim.

Fazat e vlerësimit përshkrues, kanë si qëllim të vlerësojnë arritjet e nxënësve çdo tre muaj. Këto arritje bazohen në përmbushjen e objektivave specifike që ka secila linjë e programit për çdo lëndë të klasës së tretë.

\*\*\*\*\*Vlerësimi përshkrues ka si qëllim të evidentojë anat e forta, dobësitë dhe vështirësitë konkrete që ka nxënësi në çdo linjë të programeve lëndore. Nëpërmjet këtij vlerësimi prindërit e kanë më të qartë në cilin nivel është përparimi i fëmijës së tyre.

## Tabela e plotë :

Deri në klasën e dytë vlerësimi i nxënësve bëhet sipas shprehjeve sintetizuese. Në mënyrë të përmbledhur ky vlerësim përgjithësohet më tej me shprehjet: “Dobët”, “Mjaftueshëm”, “Mirë”, “Shumë mirë”.

Në klasën e tretë vlerësimi i nxënësve realizohet nëpërmjet vlerësimit përshkrues i cili përmban 5 nivele<sup>1</sup> dhe do të realizohet sipas shpjegimeve të mëposhtme<sup>2</sup>:

**Shkalla 1: “Arritje të pakënaqshme”** do të konsiderohen kur nxënësi nuk përmbush asnjë nga objektivat bazë të të nxënit ( kjo përkon me vlerësimin Dobët ose me notën 4).

**Shkalla 2 “Arritje që kanë nevojë për përmirësim”** do të thotë që nxënësi ka arritur vetëm pak nga objektivat bazë të të nxënit, që kërkon mbështetje dhe punë të vazhdueshme nga ana e mësuesit (kjo përkon me vlerësimin Mjaftueshëm ose me notat 5 dhe 6).

---

<sup>1</sup> Numrat nga 1 deri në 5 të cilat korespondojnë me shkallet e vlerësimit përshkrues do të vendosen në regjistër.

<sup>2</sup> \*\*\* Në tabelë fjalët “dobët”, “mjaftueshëm”, “mirë”, “shumë mire”, jepen për të orientuar mësuesit me formën e re të vlerësimit përshkrues.

**Shkalla 3 “Arritje të kënaqshme”** do të konsiderohen kur nxënësi ka përmbushur objektivat bazë të të nxënës dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë (kjo përkon me vlerësimin Mirë ose me notën 7).

**Shkalla 4 “Arritje shumë të kënaqshme”** do të konsiderohen kur nxënësi ka përmbushur një pjesë të mirë të objektivave të të nxënës (kjo përkon me vlerësimin Shumë mirë ose me notat 8 dhe 9).

**Shkalla 5 “Arritje të shkëlqyera”** do të konsiderohen kur fëmija përmbush plotësisht objektivat e të nxënës nxënës (kjo përkon me vlerësimin Shkëlqyeshëm ose me notën 10).

### Shpjegimi për secilën shkallë të vlerësimit:

#### **Nxënësi që paraqet arritje të pakënaqshme (shkalla 1)**

- Plotëson pak detyra.
- Ka nevojë të kujtohet shpesh për të bërë detyrat dhe është rrallë herë i motivuar.
- Detyrat i mungojnë, janë të paplotësuara, të pasakta dhe mund t’i dorëzojë me vonësë.
- Rrallë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutimet në klasë dhe në bashkëpunim me shokët.

#### **Nxënësi që paraqet arritje që kanë nevojë për përmirësim (shkalla 2)**

- Është i motivuar për të plotësuar detyrat, megjithatë disa prej tyre mund të mos zhvillohen plotësisht.
- Herë pas here duhet kujtuar që të bëjë detyrat.
- Ndonjëherë dëgjon me vëmendje dhe merr pjesë në aktivitete dhe diskutime në klasë dhe punon bashkërisht në grupe.

#### **Nxënësi që paraqet arritje të kënaqshme (shkalla 3)**

- Zakonisht është i motivuar dhe i përqendruar në detyra.
- I plotëson detyrat në kohë.

- Zakonisht dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe punon bashkërisht në grupe.

#### **Nxënësi që paraqet arritje shumë të kënaqshme (shkalla 4)**

- I vetë-motivuar.
- I plotëson detyrat me kënaqësi.
- Shpesh kërkon dhe vihet përpara sfidave.
- Thujse gjithmonë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe punon bashkërisht në grupe.

#### **Nxënësi që paraqet arritje të shkëlqyera (shkalla 5)**

- Është i vetëdrejtuar.
- Kërkon sfida.
- Plotëson detyrat me entuziazëm.
- Dëgjon me vëmendje.
- Merr pjesë me entuziazëm në diskutim dhe në aktivitetet e klasës.
- Kontribuon në ndërveprimin efektiv të grupeve bashkëvepruese.
- Merr përgjegjësi për të zgjeruar rritjen personale dhe akademike

### Plotësimi i regjistrit sipas formatit të ri të vlerësimit përshkrues

Për të realizuar vlerësimin përshkrues në regjistër do të përshtatet regjistri i klasës së dytë. Për secilën lëndë mësuesi do të ketë tre faqe në dispozicion. Ato korrespondojnë me tre fazat e vlerësimit përshkrues.

Për sa i përket vlerësimit përmbljedhës, i cili pasqyrohet edhe në dëftesë udhëzimet do të vijnë në muajt në vijim.

#### Lënda: Gjuha amtare

(Ana e majtë e regjistrit)

Nr	Muaji _____	Data e Muaji	Tema e mësimit
	<b>DATA DHE MUNGESAT</b>		
1			

(Ana e djathtë e regjistrit)

Nr.	Shënime për nivelin e përvetësimit të njohurive nga nxënësit <sup>3</sup>					<sup>4</sup> Shënime
	Të dëgjuarit	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit	Njohuri rreth sistemit gjuhësor	
1						

<sup>3</sup> Nën secilën linjë shënohen numrat nga 1 deri në 5 që korrespondojnë me shkallët e vlerësimit.

<sup>4</sup> **Kolona e fundit (Përfundime) të shërbejë për shënime të mësuesit**

## Vlerësimi përshkrues sipas lëndëve mësimore

### ***Të përgjithshme: GJUHA SHQIPE***

*Në lëndën e gjuhës shqipe janë gjithsej 210 orë mësimore (35 javë x 6 orë/javë).*

*Vlerësimi përshkrues do të realizohet nga mësuesi brenda 70 orëve mësimore (kjo është fleksibël me 1 orë ose 2 orë plus, minus në varësi të mbylljes së kapitullit). Vlerësimi realizohet duke përmbledhur njohuritë nga të gjitha linjat.*

- **Të dëgjuarit**
- **Të folurit**
- **Të lexuarit**
- **Të shkruarit**
- **Njohuri rreth sistemit gjuhësor**

### ***Të përgjithshme: GJUHA E HUAJ***

*Në lëndën e gjuhës së huaj janë gjithsej 70 orë mësimore (35 javë x 2orë/javë).*

*Vlerësimi përshkrues do të realizohet nga mësuesi çdo 23-24 orë mësimore (kjo është fleksibël me 1 orë ose 2 orë plus, minus në varësi të mbylljes së kapitullit). Vlerësimi realizohet duke përmbledhur njohuritë nga të gjitha linjat.*

- **Të dëgjuarit**
- **Të folurit**
- **Të lexuarit**
- **Të shkruarit**

### ***Të përgjithshme: MATEMATIKA***

*Në lëndën e matematikës janë gjithsej 175 orë mësimore (35 javë x 5 orë/javë).*

*Vlerësimi përshkrues do të realizohet nga mësuesi brenda 58 orë mësimore (kjo është fleksibël me 1 orë ose 2 orë plus, minus në varësi të mbylljes së kapitullit). Vlerësimi realizohet duke përmbledhur njohuritë nga të gjitha linjat.*

- **Numri**
- **Matja**
- **Gjeometria**
- **Algjebra dhe funksioni**
- **Mbledhja, organizimi dhe përpunimi i të dhënave; probabiliteti**

***Të përgjithshme: DITURI NATYRE***

*Në lëndën e diturisë së natyrës janë gjithsej 70 orë mësimore (35 javë x 2orë/javë).*

*Vlerësimi përshkrues do të realizohet nga mësuesi brenda 23-24 orë mësimore (kjo është fleksibël me 1 orë ose 2 orë plus, minus në varësi të mbylljes së kapitullit). Vlerësimi realizohet duke përmbledhur njohuritë nga të gjitha linjat.*

- **Gjallesat dhe proceset e jetës**
- **Mjedisi fizik**
- **Vendet dhe Njerëzit**
- **Lëndët dhe vetitë e tyre**

***Të përgjithshme: EDUKIMI QYTETAR***

*Në lëndën e edukimit qytetar janë gjithsej 35 orë mësimore (35 javë x 1orë/javë).*

*Vlerësimi përshkrues do të realizohet nga mësuesi brenda 11-12 orë mësimore (kjo është fleksibël me 1 orë ose 2 orë plus, minus në varësi të mbylljes së kapitullit). Vlerësimi realizohet duke përmbledhur njohuritë nga të gjitha linjat.*

- **Individi dhe grupi**
- **Komunikimi në shoqëri**
- **Rregullat**
- **Shërbimet në komunitet**
- **Rruga**
- **Shëndeti dhe Mjedisi**
- **Prodhimi dhe Shpërndarja**

### ***Të përgjithshme: EDUKIMI FIGURATIV***

*Në lëndën e edukimit figurativ janë gjithsej 35 orë mësimore (35 javë x 1orë/javë).*

*Vlerësimi përshkrues do të realizohet nga mësuesi brenda 11-12 orë mësimore (kjo është fleksibël me 1 orë ose 2 orë plus, minus në varësi të mbylljes së kapitullit). Vlerësimi realizohet duke përmbledhur njohuritë nga të gjitha linjat.*

- **Baza materiale, procese e teknika**
- **Elemente dhe parime**
- **Tematika**
- **Histori dhe kulturë**
- **Analiza, interpretimi, vlerësimi**
- **Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin**

### ***Të përgjithshme: EDUKIMI MUZIKOR***

*Në lëndën e edukimit muzikor janë gjithsej 35 orë mësimore (35 javë x 1orë/javë).*

*Vlerësimi përshkrues do të realizohet nga mësuesi brenda 11-12 orë mësimore (kjo është fleksibël me 1 orë ose 2 orë plus, minus në varësi të mbylljes së kapitullit). Vlerësimi realizohet duke përmbledhur njohuritë nga të gjitha linjat.*

- **Këndimi**
- **Bazat e arsimimit muzikor**
- **Luajtja në instrument**
- **Dëgjimi muzikor**
- **Të shprehurit dhe krijimi muzikor**

### ***Të përgjithshme: AFTESIM TEKNOLOGJIK***

*Në lëndën e aftësisimit teknologjik janë gjithsej 35 orë mësimore (35 javë x 1orë/javë).*

*Vlerësimi përshkrues do të realizohet nga mësuesi brenda 11-12 orë mësimore (kjo është fleksibël me 1 orë ose 2 orë plus, minus në varësi të mbylljes së kapitullit). Vlerësimi realizohet duke përmbledhur njohuritë nga të gjitha linjat.*

- **Njeriu dhe shoqëria në teknologji**
- **Teknologjia e materialeve dhe proceseve**
- **Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia**
- **Teknologjia e informacionit dhe komunikimit**

### ***Të përgjithshme: EDUKIMI FIZIK***

*Në lëndën e edukimit fizik janë gjithsej 70 orë mësimore (35 javë x 2orë/javë).*

*Vlerësimi përshkrues do të realizohet nga mësuesi brenda 23-24 orë mësimore ( kjo është fleksibël me 1 orë ose 2 orë plus, minus në varësi të mbylljes së kapitullit). Vlerësimi realizohet duke përmbledhur njohuritë nga të gjitha linjat.*

- **Njohuri të edukimit fizik**
- **Aftësi lëvizore bazë**
- **Manipulim lëvizjesh**
- **Lojëra lëvizore**
- **Lëvizje të thjeshta ritmike**

**Për pyetje dhe sqarime të mëtejshme për realizimin e vlerësimit përshkrues në klasën e tretë, kontaktoni personat përgjegjës pranë IZHA: Aurela Zisi : [aurelazisi@yahoo.com](mailto:aurelazisi@yahoo.com) & Irida Sina: [irida.sina@gmail.com](mailto:irida.sina@gmail.com), të cilat do të furnizojnë DAR/ZA me materiale mbështetëse për të realizuar vlerësimin përshkrues, çdo tre muaj si dhe vlerësimin përmbledhës në fund të vitit shkollor.**



## Shpjegime dhe komente të mbas mbledhjes

### Plotësimi i regjistrit në klasat kolektive

Mësuesit e klasave kolektive, do të plotësojnë regjistër të veçantë për nxënësit e klasës së tretë (do të përdorin regjistrin e klasës së dytë) i cili do përshtatet si më lartë. Ndërkohë vazhdojnë të plotësojnë të njëjtin regjistër për klasat e tjera.

### Plotësimi i portofolit, dhe vlerësimi i dokumenteve që janë pjesë e tij

Për të dhënë vlerësimin sipas rubrikave të mëposhtme mësuesi është fleksibël që ti ndryshojë përqindjet sipas natyrës dhe veçorive që ka secila lëndë (pesha rri e pandryshueshme për lëndët si : matematika, gjuha shqipe, gjuha e huaj, dituri natyre).

- Puna në klasë: 30 %
- Punime të nxënësve (projekte, module, punë të ndryshme individuale): 25%
- Detyra shtëpie:15%
- Testet dhe detyra kontrolli: 30%